




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK KORÇË

Nr. 860 Prot.

Korçë, më 23.11.2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë.

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORISË Ë MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”. Ofruesi publik i AFP-së Qendra e Formimit Profesional Publik, Korçë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin SPECIALIST FINANCE

- Pozicioni:

a) Specialist Finance ---- 1 person

**I. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

*Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:*

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

*Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:*

- të ketë të paktën diplomë të nivelit Bachelor, në shkenca ekonomike, sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës;
- të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione të ngjashme, sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës;
- të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

## 2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 12.12.2023

DREJTOR  
i Komanduar  
Adela MYTEBERI

